

Në bazë të nenit 38 paragrafi 1, pika 2, e në lidhje me nenit 59 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fl. zyr. MZ”, nr. 2/18 dhe 34/19) nenit 42 paragrafi 1 pika 2 dhe nenit 86 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës”, nr. 48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më ____. ____. _____, miraton

V E N D I M

për dhënien e pëlqimit në Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 01-374/19 dhe 01-375/19 të datës 29.11.2019 për ndarjen e ndihmës financiare dhe në mall Qeverisë së Shqipërisë

Neni 1

Jepet pëlqimi në Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 01-374/19 dhe 01-375/19 të datës 29.11.2019 për ndarjen e ndihmës financiare dhe në madhë Qeverisë së Shqipërisë në vlerën totale prej 23.000,00 Euro Qeverisë së Shqipërisë.

Neni 2

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës.

Numër: _____
Ulqin, më ____. ____. _____

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT
KRYETARI
Dr. Ilir Çapuni

Arsyetim

Baza juridike për nxjerrjen e këtij vendimi është në nenin 58 paragraf 1 pika 3 dhe nenit 59 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe nenit 83 paragraf 1 pika 3 dhe nenit 86 të Statutit të Komunës së Ulqinit, me të cilat është paraparë detyrimi i Kryetarit të Komunës që të kujdeset për zbatimin e ligjit dhe akteve të tjera të përgjithëshme, zhvillimit strategjik të Komunës dhe planeve të tjera zhvillimore si dhe për zbatimin e dokumenteve strategjike me interes shtetëror si dhe e drejta e kryetarit të komunës që përkohësisht të sjell akte nga kompetenca e Kuvendit, nëse Kuvendi nuk është në gjendje të mblidhet, me kusht që aktin ta sjell në vërtetim Kuvendi në seancën e parë të rradhës.

Arsye për sjelljen e vendimit është urgjenca në dërgimin e ndihmave humanitare familjeve të dëmtuara në Republikën e Shqipërisë, të rëna nga tërmeti që ndodhi në Durrës dhe rrethinë me 26.11.2019.